

Deklarata e 25 vjetorit të konferencës së Çmimit Sakharov nga Rrjeti i Çmimit Sakharov



Rendi përpara nga majta në të djathtë: Shirin Ebadi (përfaqëson N. Sotoudeh), Xanana Gusmao, Wei Jinsheng, Taslima Nasreen, President i PE- së Martin Schulz, Malala Yousafzai, ish-Presidenti i PE Lord Plumb, Vildana Selimbegovic nga Oslobodjenje, Leyla Zana, Salima Ghezali, Fernando Savater i Basta Ya, Dom Zacarias Kamwenho.

Rendi prapa nga e majta në të djathtë: Nurit Peled, Guillermo Farinas, Alexander Milinkievich, Christophe Deloire i RSF, Rosa Maria Paya (përfaqëson Oswaldo Paya), Berta Soler i Damas de Blanco, Hauwa Ibrahim, Salih Osman, Ahmed El Senussi dhe Karim Lahidji (përfaqësojnë J. Panahi).

20 nëntor 2013, Strasburg

A. Në lidhje me deklaratën e themelimit të Rrjetit Çmimit Sakharov të vitit 2008 ku u tha se “duke njohur rolin e veçantë të laureatëve të çmimit Sakharov si Ambasadorë të Lirisë së Mendimit, ne, të nënshkruarit , jemi pajtuar t’i bashkojmë përpjekjet në mbështetje të mbrojtësve të të drejtave njerëzore rreth e qark botës përmes veprimeve të përbashkëta nga ana e laureatëve të çmimit Sakharov bashkërisht dhe me mbështetjen e Parlamentit Evropian”;

B. Kurse shtetet anëtare të Bashkimit Evropian në konkluzionet e Këshillit mbi të Drejtat e Njeriut dhe Demokracinë me datën 25 qershor 2012 u zotuan se do të punojnë me partnerë në forume shumëpalëshe dhe organizata ndërkombëtare në fushën e të drejtave të njeriut dhe demokracisë; kurse Këshilli i Bashkimit Evropian e ka theksuar rëndësinë e Përfaqësuesit të Posaçëm të BE-së (PPBE) për të Drejtat e Njeriut për rritjen e efektivitetit dhe shfaqjen e politikës së BE-së mbi të

Drejtat e Njeriut dhe deklaroi përkushtimin e tij se do të punojë ngushtë me Parlamentin Evropian dhe Komisionin Evropian dhe në frymën e partneritet të vërtete me shoqërinë civile;

C. Ndërsa Parlamenti Evropian, në rezolutën e vet të datës 13 dhjetor 2012 me rastin e shqyrtimit të strategjisë së BE mbi të drejtat e njeriut ka theksuar nevojën për shfrytëzim më të mirë të potencialit të Rrjetit të Çmimit Sakharov të PE-së nga ana e institucioneve të tjera të BE-së, rekomandoi se delegacionet e PE të cilat shkojnë në mision në një vend ku gjendja e të drejtave të njeriut është shqetësuese do të duhej të kishin anëtarë të cilëve tu caktoheshin detyra specifike për të ngritur çështje të lidhura me të drejtat e njeriut, dhe shprehu mendimet se secilit delegacion i përhershëm i parlamentit dhe secili komitet përkatës do të duhej ta kishte një anëtar të ngarkuar me detyra specifike që lidhen me monitorimin e të drejtave të njeriut në rajon, shtet apo fushën e caktuar tematike, dhe se personat e caktuar do të duhej t'i raportonin Nën-komisionit të Parlamentit mbi të Drejtat e Njeriut;

ALARMET, FUSHATAT DHE VEPRIMI MBËSHTETËS

1. Rrjeti i Çmimit Sakharov do të bëjë përpjekje të identifikojë çështjet të cilat lidhen me të drejtat e njeriut ku laureatët mund të punojnë bashkë dhe me Bashkimin Evropian dhe shoqërinë civile në favor të mbrojtjes së të drejtave të njeriut rreth e qark botës, duke i kushtuar vëmendje të posaçme situatës politike të Laureatit të Çmimit Sakharov; anëtarët e rrjetit përkushtohen të veprojnë në baza individuale ose së bashku si sistem global alarmi kundër shkeljes së të drejtave njerëzore dhe të mbajnë një qëndrim për sa i përket respektimit të të drejtave universale të njeriut përmes veprimit të përbashkët dhe individual, duke përfshirë edhe pjesëmarrjen në evenimente mbi të drejtat e njeriut dhe publikimin e ankesave dhe deklaratave si edhe promovimin e parimeve të tyre në shtetet përkatëse të tyre përkatëse dhe fushat e veprimit;

2. Anëtarët e Rrjetit mundën ose në grup ose ndaras, në mënyrë simbolike të pranojnë mbrojtës të të drejtave njerëzore në mënyrë që të tërheqin vëmendjen ndërkombëtare drejt kauzës dhe situatës së tyre dhe duke bërë një gjë të tillë japin kontribut në mbrojtjen kundër represionit, arrestimeve arbitrare, torturës, ekzekutimit të menjëhershëm apo dënimeve me vdekje; Rrjeti i Çmimit Sakharov është i përkushtuar të mbështesë laureatët dhe mbrojtësit tjerë të të drejtave të njeriut të cilët janë të dënuar me burgim ose ndaj të cilëve zhvillohet proces gjyqësor lidhur me aktivitetet e tyre në mbrojtje të të drejtave të njeriut, në grup ose individualisht, duke tërhequr vëmendjen ndërkombëtare ndaj gjendjes së tyre të vështirë dhe, aty ku është e mundur, duke marrë pjesë në procese gjyqësore ku jepet ndihma drejt mbrojtjes së tyre nga burgosjet dhe dënimet arbitrare.

3. Rrjeti i Çmimit Sakharov denoncon pandëshkueshmërinë dhe synon mbrojtjen e lirisë nga shkeljet dhe format të tjera të aktiviteteve armiqësore të shtetit kundër individëve dhe grupeve; Rrjeti i Çmimit Sakharov zotohet se do të punojë kundër mekanizmave të pandëshkueshmërisë të cilët mbrojnë organizatat shtetërore dhe individët të cilët punojnë brenda strukturave shtetërore të cilat kryejnë genocid apo vepra tjera në shkelje të konventave të OKB-së mbi të drejtat e njeriut dhe aktet e torturës, rrahjes dhe burgosjeve arbitrare në mesin e shkeljeve të tjera kundër njerëzimit; Rrjeti u bën apel organeve ndërkombëtare ta ruajnë një regjistër mbi numrin e rasteve të pandëshkuara siç ka ndodhur me juridiksione të ndryshme të periudhës pas lufte;

4. Rrjeti i Çmimit Sakharov do të marrë parasysh themelimin e iniciativës nga ana e laureatëve të Çmimit Sakharov për fitim të Azilit të përkohshëm për Mbrojtësit e të Drejtave të Njeriut dhe familjeve të tyre që janë në rrezik nga vetë shteti i tyre, në bashkëpunim me organizatat e shoqërisë civile; Anëtarët e Rrjetit zotohen se do të rekomandojnë mbrojtësit e vërtetë të të drejtave të njeriut

në nevojë reale për strehim ose pushim në betejën e tyre; Anëtarët e Rrjetit mundën të nënshkruajnë një letër në mbështetje të mbrojtësve të të drejtave të njeriut kur ata aplikojnë për vizë azili.

BASHKËPUNIMI DHE PRAKTIKAT E MIRA TË INSTITUCIONEVE TË BE-së

5. Laureatët e çmimit Sakharov zotohen të informojnë Parlamentin Evropian, në veçanti Komisioni i Punëve të Jashtme (KPJ) dhe Nën-komisioni i lidhur me të Drejtat e Njeriut (DROI), dhe pikat e kontaktit për të drejtat e njeriut brenda delegacioneve të BE-së si dhe me përpikëri t'i alarmojnë këto të fundit në lidhje me zhvillimet e rëndësishme që lidhen me çështje të të drejtave të njeriut në shtetet përkatësepërpatëse dhe në fushat e veprimit; laureatët zotohen të lehtësojnë kontaktet ndërmjet BE-së dhe shoqërisë civile dhe organizatave ndërkombëtare ku mundën të mbështeten në to për mbështetje praktike dhe mbrojtje të laureatëve dhe shoqërisë civile në shtetet e tyre;

6. Rrjeti i Çmimit Sakharov zotohet të ofrojë të dhëna rreth çështjes së lidhur me të drejtat e njeriut gjatë misionit të vëzhgimit të procesit elektoral të BE-së me qëllim të fuqizimit të demokratizimit dhe të drejtave të njeriut;

7. Laureatët e çmimit Sakharov zotohen të takohen dhe diskutojnë çështje të interesit të përbashkët lidhur me të drejtat e njeriut ku delegacionet parlamentare udhëtojnë për në shtete të treta dhe laureatët vizitojnë Parlamentin Evropian;

8. Rrjeti i çmimit Sakharov i bën apel BE-së për një përkushtim thelbësor diplomatik të anëtarëve të vetë përmes Shërbimit Evropian për Veprimet të Jashtëm dhe përfaqësuesve të vendeve anëtare në veçanti për mbrojtjen e Laureatëve të çmimit Sakharov dhe mbrojtësve të të drejtave të njeriut në rrezik;

9. Rrjeti i Çmimit Sakharov i bën apel BE-së për të ngriturzërin kur has në rastet e shkeljeve të vazhdueshme të të drejtave të njeriut dhe të sigurojë se mesazhi dëgjohet nga të dyja palët si nga qeveria abuzuese ashtu edhe nga populli;

10. Rrjeti i çmimit Sakharov i bën apel ministrave të punëve të jashtme të BE-së të organizojnë debate publike dhe evenimente lidhur me të drejtat e njeriut me pjesëmarrje të Anëtarëve të Rrjetit të Çmimit Sakharov; Komisioni i Punëve të Jashtme (KPJ) dhe Nënkomisioni i lidhur me të Drejtat e Njeriut (DROI) do të ngrenëvetëdijen në mes komisioneve partnere brenda parlamenteve kombëtare të BE-së rreth punës Rrjetit të Çmimit Sakharov;

11. Rrjeti i Çmimit Sakharov i bën apel parlamenteve kombëtarekombëtre të vendeve anëtare të BE-së ta përdorin fuqinë e ndikimit në të dyja nivelet bilateral dhe multilateral, brenda kornizës së kontakteve ndërparlamentare dhe forume, për t'i nxitur palët e kundërta të përfshihen dhe t'i përkushtohen kauzës së mbrojtjes së të drejtave të njeriut dhe dinjitetit njerëzor në vendet e tyre përkatëse;

12. Rrjeti i Çmimit Sakharov fton të merret parasysh themelimi i një komisioni ad hoc i përbërë prej laureatëve të Çmimit Sakharov dhe parlamentarëve evropianë në organizimin e përbashkët me vizita nga ana e institucioneve të BE-së kryer në shtetet ku situata e të drejtave të njeriut është në rrezik dhe për të hetuar shkeljet e të drejtave të njeriut dhe lirive të njeriut në terren, me anë të vizitave kushtuar viktimave, mbrojtësve të të drejtave të njeriut, OJQ-ve dhe grupeve të shoqërisë civile në vendin apo rajonin në fjalë.

ARSIMIMI DHE VETËDIJA GLOBALE RRETH STANDARDEVE TË TË DREJTAVE TË NJERIUT

13. Anëtarët e Rrjetit të Çmimit Sakharov zotohen si individualisht ashtu edhe bashkërisht t'i mbështesin fushatat lidhur me të drejtat e njeriut në nivel ndërkombëtar, në bashkëpunim me organizatat ndërkombëtare për të drejtat e njeriut dhe grupe të shoqërisë civile, duke ngritur zërin publikisht kundër shkeljeve të të drejtave të njeriut, në forume ndërkombëtare, rajonale dhe lokale, në media dhe në forumet e ndryshme akademike, kulturore e të tjera forume të ngjashme;

14. Rrjeti i Çmimit Sakharov zotohet të ndajë bursa studimi të çmimit Sakharov në fushën e të drejtave të njeriut për të ngritur vetëdijen rreth standardeve ndërkombëtare të të drejtave të njeriut në shtetet e tyre dhe përfshirjen e tyre brenda legjislacionit kombëtar; anëtarët e Rrjetit do të bëjnë përpjekje t'i rekomandojnë kandidatët e aftë të çojnë përpara çështjen e të drejtave të njeriut rreth e qark botës; anëtarët zotohen për të dhënë kontributin nga ekspertiza dhe përvoja e tyre tek programi i bursave; Parlamenti Evropian do të marrë parasysh ofrimin e trajnimeve tek mbrojtësit e të drejtave të njeriut për përmirësimin e njohurive në çështjet e të drejtave të njeriut dhe standardeve nga ana e tyre.

15. Anëtarët e Rrjetit të çmimit Sakharov, individualisht dhe bashkërisht, zotohen se do të japin mbështetje për fushatave ndërkombëtare për t'i dhënë fund dhunës kundër fëmijëve dhe për të promovuar arsimimin e fëmijëve, përmes ngritjes së zërit lidhur me fushatat dhe ngjarjet online, duke bërë deklaratat dhe duke kryer vizita në terren ku fëmijët jetojnë në kushte të vështira;

ANKESAT

16. Rrjeti i Çmimit Sakharov i bën apel autoriteteve të Iranit për faljen e dënimit ndaj Laureatit të çmimit Sakharov Nasrin Sotoudeh, e cila është e dënuar për mbrojtje ligjore ndaj të burgosurve politikë, dhe Jafar Panahi, për ushtrimin e lirisë së shprehjes dhe shoqërimit, dhe apelon që emrat e tyre të lirohen nga të gjitha akuzat dhe tu ndërpritet kufizimi i udhëtimit;

17. Rrjeti i Çmimit Sakharov i bën apel autoriteteve kineze t'i ndalojnë kufizimet e caktuara ndaj Laureatit të çmimit Sakharov Hu Jia dhe t'ia lejojnë lirinë e shprehjes dhe shoqërimit, lirinë e lëvizjes së lirë jashtë vendit, t'i ndalojnë arrestet shtëpiake në mënyrë arbitrare ndaj tij dhe ta mbrojnë kundër dhunës me rrahje të ushtruar ndaj tij; Rrjeti i Çmimit Sakharov i bën apel autoriteteve kineze t'i lejojnë mbrojtësit e të drejtave të njeriut dhe të burgosurit politik ta shprehin mendimin e tyre lirshëm, pa frikën e ndëshkimit, dhe u bën apel të lirohen të gjithë mbrojtësive të të drejtave të njeriut;

18. Rrjeti i Çmimit Sakharov shpreh shqetësim të thellë dhe solidaritet me popullin e Sirisë dhe Laureatin e Çmimit Sakharov Razan Zaitouneh, i cili akoma gjendet në Damask, në rrethana tragjike të luftës së zgjatur; dhe i bën apel autoriteteve në Siri t'i ndalin aksionet ushtarake drejtuar civilëve dhe të respektojnë të drejtat dhe dignitetin e njeriut dhe kërkon nga bashkësia ndërkombëtare të sigurojë ndihmë humanitare dhe mjekësore për popullin e Sirisë brenda dhe jashtë Sirisë.

19. Rrjeti i çmimit Sakharov dënon të gjitha veprimet e ndërmarra ndaj Laureatëve të tjerë të Çmimit Sakharov dhe të cilat mund të cilësohen si shkelje e të drejtave të njeriut, lirisë së lëvizjes, lirisë së mendimit, lirisë së shprehjes dhe të drejtave civile, veçanërisht arrestimet, rrahjet dhe

kufizimet në lirinë e shoqërimit, Rrjeti bën thirrje të lirohen të gjithë të burgosurit politikë dhe të burgosurit e ndërgjegjes në Kubë dhe në vende të tjera anembanë globit, përfshirë edhe Laureatin e çmimit të Sakharov Dama de Blanco Sonia Garro, dhe bën thirrje të kryhet një hetim lidhur me vdekjen e Laureatit të Çmimit Sakharov të vitit 2002 Oswaldo Payá;

20. Rrjeti i Çmimit Sakharov mirëpret bisedimet paqësore në mes qeverisë turke dhe udhëheqësit të burgosur kurd Abdullah Ocalan në gjetjen e një zgjidhjeje afatgjatë lidhur me konfliktin që ka zgjatur më se një dekadë me kurdët;

21. Rrjeti i Çmimit Sakharov zotohet të mbajë së paku një takim gjatë mandatit të legjislativit të Parlamentit Evropian dhe të ndërtojë lidhje edhe më të forta me anëtarët e vet për fuqizimin e mëtejshëm në mbështetje të të drejtave universale dhe dinjitetit të njeriut.